

DOKUMENT UDHËZUES PËR APLIKANTË

NËN-GRANTE PËR FUQIZIMIN E ORGANIZATAVE MJEDISORE NË SHQIPËRI

KODI THIRRJES: 55130002

MODULI INISIATIVËS DHE PARTNERITETIT

Ky projekt mbështetet nga:
Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Sida)

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Shënim:

Ky udhëzues ofron informacionin e nevojshëm për të gjithë të Organizatat me fokus mjedisin në Shqipëri, mbi qasjen, kriteret dhe territorin që mbulohet nga projekt-propozime në kuadër të projektit Green-AL. “Fuqizimi Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri”

Për konsorciumin, prezenca e të cilëve do të jetë pranë çdo rajoni, synimi është “Projekt Fitues konsiderohet ai që bazohet mbi objektiva të realizueshëm dhe indikator të matshëm”. Në kuadër të kësaj thirrje inkurajojmë të shohim ndërhyrje të cilat kulminojnë me zgjidhjen tematike apo praktike të një problemi mjedisor, klimatik, natyror apo urban.

Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit. Thirrja vjen në kulmin e stinës së verës dhe në një kohë kur gjendja e pandemisë globale qëndron ende në fuqi andaj do të qëndrojë e hapur deri në datën **15.09.2021 ora 16.00**.

Për një aplikim të suksesshëm, dokumentet e kërkuara nga ky udhëzues duhen dorëzuar të gjitha së bashku si në format elektronik po ashtu edhe fizikisht të mbyllur në një zarf të formatit.

Aplikimi dhe vlerësimet e kësaj thirrje do të mbyllen vetëm në një fazë, duke mos harruar periudhën e ankimit përpara nënshkrimit të kontratave me fituesit e shpallur nga bordi vlerësues.

Të gjithë të interesuarit janë të lutur që për çdo informacion shtesë, paqartësi apo orientim të kontaktojnë në çdo moment adresën co-plan@co-plan.org, por jo më vonë se data 20.8.2021 ora 16.00.

PËRMBAJTA

KUSH MUND TË APLIKOJË.....	3
SHTRIRJA TERRITORIALE.....	3
AFATI DHE MËNYRA E DORËZIMIT TË APLIKIMEVE.....	4
DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM.....	4
NË LIDHJE ME “Green-AL”	5
OBJEKTIVAT & PRIORITETET E GRANTEVE TË INICIATIVËS DHE PARTNERITETIT	6
TIPOLOGJIA E MBËSHTETJES FINANCIARE:.....	7
KRITERET E THIRRJES	8
(1) Aktorët	8
(2) Projektet.....	9
(3) Kostot.....	11
VIZIBILITETI	12
VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE.....	12
i. Kontrolli Administrativ dhe Vlerësimi Paraprak.....	12
ii. Vlerësimi Cilësor/Përmbajtësor i Aplikimit të Plotë	13
iii. Procedura e përzgjedhjes.....	15

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Mbështetur nga Qeveria e Suedisë



KUSH MUND TË APLIKOJË

Green-AL mbështet përmes instrumenteve të granteve të iniciativës dhe të partneritetit organizatat e shoqërisë civile (OSHC¹) me fokus mbrojtjen, promovimin dhe ripërtëritjen e mjedisit në Shqipëri.

Për tu konsideruar i/e kualifikuar në aplikimin e një **granti iniciative**, aplikanti (organizata) duhet të ketë profil dhe mision të qartë mjedisor, minimumi **një vit përvojë** në fushën e mjedisit dhe të jetë i/e themeluar në Shqipëri, referuar Legjislacionit vendas në fuqi. Këto grante janë të dedikuara vetëm për një organizatë.

Për tu konsideruar i kualifikuar në aplikimin e një **granti partneriteti**, aplikanti (organizata lider / udhëheqëse) duhet të ketë duhet të ketë profil dhe mision të qartë mjedisor, minimumi **3 vite përvojë** në fushën e mjedisit dhe të jetë e themeluar në Shqipëri, referuar Legjislacionit vendas në fuqi.

Këto grante janë të dedikuara për partneritet midis organizatës udhëheqëse me të paktën 3 partnerë të tjerë, të cilët mund të jenë:

- a. OSHC të tjera që kanë eksperiencë dhe interes në fushën e mjedisit;
- b. Organizime apo grupe formale rinore, kulturore, gjinore, etj.;
- c. Departamente nga Fakultete Publike dhe Private;
- d. Institute Kërkimore;
- e. Institucione dhe autoritete vendore e rajonale;

Kujdes: Aplikanti udhëheqës për grantet e partneritetit do të jetë përgjegjës për pëfshirjen në buxhetin e tij të aktiviteteve dhe shpenzimeve që do të kryhen apo zbatohen nga partnerët. Është e këshillueshme që aplikimi të shoqërohet me një Memorandum Bashkëpunimi apo marrëveshje paraprake që saktëson qëllimin, objektivat, rezultatet, rolet dhe buxhetin e gjithsecilit partner në këtë partneritet. Partnerët duhet të plotësojnë formularin mandatit, pjesë e dokumentit Aneks nr.1

SHTRIRJA TERRITORIALE.

Projekti do të zbatohet në Shqipëri, përkatësisht në 4 rajone:

- **Rajoni Qendror**, i cili përfshin qarqet **Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier**;
(përfaqësuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit)
- **Rajoni Veri-Lindor**, i cili përfshin qarqet **Dibër dhe Kukës**;
(përfaqësuar nga CISP, Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli)
- **Rajoni Veri-Perëndimor**, i cili përfshin qarqet **Shkodër dhe Lezhë**;
(përfaqësuar nga VIS, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo)
- **Rajoni Jugor**, i cili përfshin qarqet **Vlorë, Gjirokastrë, Korçë dhe Berat**.
(përfaqësuar nga COSV, Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario)

Prezenca rajonale e Green-AL, mbështetja tematike dhe teknike e saj do të duhet të merret në konsideratë nga çdo aplikant apo partneritet. Rrjeti ynë do të ofrojë në momentet e duhura të gjithë mbështetjen e drejtpërdrejtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e skemës së grantit fitues.

¹ Organizata të shoqërisë civile janë ato organizata të cilat janë regjistruar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar për organizatat jofitimprurëse dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij konfigurimi rajonal, OSHC-të që synojnë të aplikojnë sidomos për **grante të iniciativës** duhet medoemos të fokusojnë veprimtarinë e tyre të propozuar në Bashkinë apo Njësinë Administrative ku vërtet kanë legjitimitet të përfaqësimit të çështjeve apo komuniteteve nga eksperiencia e afërt.

Aplikantët e interesuar për **grante partneriteti** duhet medoemos të fokusojnë veprimtarinë e tyre në nivel Qarku ose Bashkie. Pikërisht aty ku kanë vërtet kanë legjitimitet të përfaqësimit të çështjeve apo komuniteteve nga eksperiencia e afërt. Do të mbështeten si të preferuara, bashkëpunime ku partnerët e zgjedhur nga aplikanti lider, qofshin këto autoritete, organizata, institute, departamente, grupime apo media, të cilat janë pjesë e kontekstit, Bashkisë apo Qarkut ku do të ndodh ngjarja dhe aktivitetet.

AFATI DHE MËNYRA E DORËZIMIT TË APLIKIMEVE

Thirrja do të qëndrojë e hapur deri në datën 15 Shtator 2021 (zyrtarisht mbyllet në orën 16:00).

Për të shmangur çdo problem, teknik apo fizik, në procesin e dorëzimit të aplikimeve, Co-PLAN do të kërkojë njëkohësisht, versionin elektronik (*firmosur, vulosur*) të dërguar në adresën: co-plan@co-plan.org dhe versionin fizik të dërguar të mbyllur e të vulosur në një zarf A3.

Gjatë protokollimit të zarfit, aplikanti duhet të sigurohet që zarfi të jetë tërësisht i mbyllur dhe i padëmtuar. Dorëzimet do të kryhen pranë zyrave të Co-PLAN në adresën:

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5,

Universiteti Polis, Kashar

Tiranë, Shqipëri

Sugjerojmë të gjithë palët e interesuara të shmangin dorëzimin në momentin e fundit pasi protokollimi i dosjeve merr kohë dhe çdo dorëzim pas orës 16.00 nuk do të trajtohet nga bordi vlerësues.

Për sqarime më të detajuara, të gjithë aplikantët ftohen të marrin pjesë në sesionin informues mbi procesin e aplikimit në datën **29/07/2021**. Agjenda dhe kredencialet e këtij takimi do të publikohen në ditën në vijim.

Aplikimi do të konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse është dërguar në të **dyja** formatet.

Një email konfirmues do t'i dërgohet secilit prej aplikantëve për të konfirmuar marrjen dhe vlefshmërinë paraprake të aplikimit. Ndonëse ky nuk është një kriter skualifikues, për lehtësi komunikimi, do t'ju inkurajonim që në tërësi dosja elektronike e aplikimit e cila do të dërgohet me email, të mos tejkalojë 10Mb.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Aplikimet për projekt-propozime duhet të dorëzohen në përputhje të plotë me përcaktimet e këtij dokumenti udhëzues. Aplikuesit duhet të përgatisin dhe të dorëzojnë aplikimet e tyre në gjuhën shqipe, me një përmbledhje (500 fjalë) në gjuhën Angleze (*pjesë integrale e Formularit të Aplikimit*).

Çdo gabim apo mospërputhje në lidhje me pikat e renditura në udhëzim për formularët e aplikimit (*p.sh. mospërputhje shumash në buxhetin e dorëzuar, mospërputhje midis aktiviteteve, burimeve dhe buxhetit*) mund të rezultojnë në refuzim të aplikimit. Sqarime do të kërkojnë vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë në pikën që pengon Bordin Vlerësues dhe Co-PLAN (në pozicionin e grant-dhënësit) të bëjë një gjykim objektiv.

Dokumentet Tip të Aplikimit:

- Format i aplikimit narrativ (Aneks 1)
- Format i buxhetit financiar (Aneks 2)
- Format i *kornizës logjike* (Aneks 3)

Dokumentet Mbështetëse kërkuar ndaj Aplikantit:

- 1) Vendimi i regjistrimit në gjykatë (kopje);
- 2) Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje);
- 3) Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (kopje);
- 4) Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën mjedisit (CV organizatës)

E rëndësishme: Sigurohuni që po dorëzoni të gjitha dokumentet mbështetëse. Aplikimet e paplota dhe që nuk plotësojnë rregullat e vendosura, do të refuzohen.

Dokumentet Orientuese nga Autoriteti Kontraktues:

- 1) Programi Green-AL (Aneks 4);

Shënim: Sigurohuni që të keni konsultuar dhe të keni kuptuar të gjithë anekset e thirrjes, sidomos nga ana e personit që do të shkuaj projektin, e kjo përpara nisjes së përpilimit të propozimit tuaj. Në to do të gjeni referenca dhe orientime të nevojshme për përpilimin e një propozimi fitues.

NË LIDHJE ME “Green-AL”

Green-AL është një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim me fondet e Qeverisë Suedeze. Si një vijimësi e mbështetjes Suedeze të konsoliduar në fuqizimin e sektorit mjedisor dhe angazhimit civil, tanimë programi Green-Albania për zbatimin e të cilit është mandatuar

Co-PLAN, *Instituti për Zhvillimin e Habitatit*, me statusin partneri lider;

CISP, *“Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli”*;

VIS, *“Volontariato Internazionale per lo Sviluppo dhe*

COSV, *Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario*,

Synimi: Mbështetje kumulative për afro 70 OSHC mjedisore përgjatë periudhës Tetor 2021 – Shtator 2023, me një kontribut total prej 785.000 Euro. Pa harruar këtu edhe inkubimin, një proces aftësimi didaktik tërësisht i hapur, i lirë dhe gjithëpërfshirës për komunitetin mjedisor në Shqipëri.

Konkretisht, Green-AL synon të ndihmojë OSHC-të në dy nga përparësitë të cilat kërkon të adresojë ky projekt:

- a) **fuqizimin tematik dhe administrativ** të Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore (OSHC-M) nëpërmjet procesit të inkubimit,
- b) mbështetjen **financiare për të faktorizuar prezencën dhe influencën ndaj çështjeve mjedisore** dhe rolin e tyre me aktorët lokal e qendror, kjo nëpërmjet moduleve të nën-granteve.

Inkubimi: Është planifikuar si një ndërhyrje nga ana e partnerëve të Green-AL për ti ardhur në ndihmë organizatave të reja dhe ekspertëve që kërkojnë të thellojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për të përfaqësuar e adresuar edhe më mirë problematikat mjedisore të ngritura prej tyre dhe komuniteteve që përfaqësojnë.

Skema e inkubimit organizohet në formën e trajnimeve informues, profesionale dhe alternative ndaj palëve të interesuara për të aplikuar për grante në projektin Green-AL si edhe për publikun apo ekspertët që kanë nevojë të forcojnë kapacitetet dhe njohuritë e tyre si tematike dhe administrative.

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Mbështetur nga Qeveria e Suedisë



Në këto trajnime, tema të cilat janë vlerësuar si prioritare, janë produkt direkt i procesit të vlerësimit të nevojave i cili është kryer partnerët gjatë periudhës përgatitore Janar – Maj 2021:

1. Administrative (si të konceptohet, shkruhet, menaxhohet, zbatohet dhe raportohet një projekt)
2. Tematike (Ujrat, Toka, Pyjet, Biodiversiteti, Ndryshimet Klimatike, Shërbimet Publike, Ekonomia Qarkulluese, Menaxhimi i Mbetjeve, Monitorimi Mjedisor etj.)
3. Trajnime mbi rëndësinë e çështjeve gjinore në OSHC dhe komunitet

OBJEKTIVAT & PRIORITETET E GRANTEVE TË INICIATIVËS DHE PARTNERITETIT

a. Objektivi i përgjithshëm:

Të kontribuojë në fuqizimin e OSHC-ve Mjedisore për të adresuar në mënyrë efektive dhe bazuar në fakte problemet që lidhen me mjedisin natyror dhe urban në Shqipëri.

Për realizimin e këtij objekti, kanë qenë vetë OSHC-e të cilat kanë piketuar 2 prioritete specifike përgjatë procesit të vlerësimit të nevojave. Proces ky i udhëhequr nga partnerët e Green-AL përgjatë pjesës së parë të vitit 2021, në konsultim me aktorët lokalë nga të gjithë rajonet e Shqipërisë.

Gjetjet specifike të këtij vlerësimi i gjeni të përmbeldhura në seksionin 2 tek kapitulli Kriterëve të Thirrjes.

Paralelisht në dispozicion të aplikantëve do të jetë një presantim i dedikuar për gjetjet nga vlerësimi nevojave.

b. Prioritetet Specifike:

Prioriteti 1: Propozimet të ndërtohen në funksion të adresimit të problematikës apo nevojës mjedisore lokale, referuar këtu edhe gjetjeve specifike për secilin rajon nga raporti vlerësimit të nevojave.

Prioriteti 2: Aplikimi i një skeme të nën-granteve që adresojnë **tema mjedisore në nivel lokal dhe rajonal, si edhe aplikon parimin e shpërndarjes gjeografikisht të barabartë të granteve.**

Green-AL pret që projekt propozimet të parashikojnë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj çështjes së ngritur. Fillimisht duhet të dalë qartë nevoja për ndërhyrjen e propozuar me pas të pasqyrohen aktivitetet e përpiluara në funksion të objektivit që kërkon të përmbushë ndërhyrja juaj. Kështu në propozim duhet të shfaqen qartësisht rezultatet specifike dhe indikatorët që do të bëjnë të mundur vlerësimin paraprak të impaktit të ndërhyrjes së propozua

Me rëndësi: Partnerët e Green-AL kanë vendosur që tematikisht aplikimet të ndërtohen nga vetë aplikuesi duke ju referuar edhe gjetjeve nga Vlerësimi Nevojave. Këtu duhet marrë në konsideratë fakti se një paketë me aktivitete të përgjithshme (shih Formularin e Aplikimit) janë vendosur si të detyrueshme nga partnerët dhe rrjedhimisht duhen përfshirë në propozimin tuaj final.

Veprimet duhet të bazohen në një qasje nga **poshtë – lart**; kjo do të thotë se, në vend që të përpiqet të shtyhen proceset kombëtare të integrohen në kontekste dhe agjenda lokale, veprimet do të përqendrohen në faktorizimin e çështjes / problematikës mjedisore në nivel lokal. Përfshirja e komunitetit, grupeve rinore, kulturore e gjinore dhe në disa raste e autoriteteve lokale do të jetë vlerë e shtuar në propozim. Gjithashtu në të dy tipet e granteve mund të parashikohen investime të karakterit publik, monitorues, riparues të cilat:

- i. në asnjë rast **nuk duhet të tejkalojnë 25% të buxhetit total të aplikantit.**
- ii. do të jenë subjekt i **vlerësimit të thelluar** nga ana e Bordit Vlerësues dhe menaxherit të projektit përpara nënshkrimit të kontratës.

Në terma më specifik, nga kjo thirrje pritet që OSHC-të të aplikojnë **minimalisht 2** nga qasjet e mëposhtme:

- i. Të përfshihen në procesin dhe dialogun me politikë-bërësit lokal;

- iiK** Të angazhojnë dhe mbështesin komunitetet apo grupimet e ndryshme në kërkesat e tyre për një mjedis të shëndetshëm apo në mbrojtje të habitatit.
- iiiK** Të prezantojnë modele inovative në menaxhimin dhe monitorimin e mjedisit në nivel vendor;
- ivK** Të kontribuojnë në edukimin mjedisor të të rinjve;
- vK** Të advokojnë alternativën më të mirë për zgjidhjen e çështjes mjedisore;
- viK** Të mbështesë iniciativa e praktika të suksesshme në kuadër të mbrojtjes, promovimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e mjedisit;
- viiK** Të mbështesin kërkimin dhe raportimin të bazuar në fakte dhe të dhëna nga terreni.

Shënim: Përdorni referenca eksplicite nga udhëzuesi kur ndërtoni një aktivitet apo ndërhyrje të bazuar mbi rekomandimet e këtij dokumenti.

TIPOLOGJIA E MBËSHTETJES FINANCIARE:

Skema e nën-granteve synon të ndihmojë në transferimin e njohurive nga qendra në kontekstin periferik / rural si edhe ndërtimin e kapaciteteve dhe fuqizimin e organizimit të aktorëve në adresimin e çështjeve mjedisore.

Temat e skemës së nën-granteve duhet të fokusohen në rezultatet e dala nga studimi i procesit të vlerësimit të nevojave nëpërmjet pyetësorëve dhe proceset e konsultimit të kryera në fillim të projektit. Për këtë ftojmë aplikantët të konsultohen me Raportin Përmbledhës të Vlerësimit të Nevojave.

Çdo grant i kërkuar në këtë thirrje duhet të akomodohet brenda limiteve minimale apo maksimale të mëposhtme (vini re se aplikimet të cilat do të kërkojnë shumën maksimale do duhet të përmbushin rrjedhimisht pjesën më të madhe të kriterëve të përshtatshmërisë së organizatës dhe propozimit)

Vlera totale në dispozicion për këtë thirrje është **400,000 Euro** nga ku 200,000 Euro janë pjesë e granteve iniciative dhe 200,000 Euro të tjera për grantet e partneritetit.

MODULI	VLERA E GRANTIT (EURO)	KOHËZGJATJA (MUJ)	APLIKUESI	AKTORË / PARTNERË
<i>Grante Initiative</i>	1.500 - 10.000	5-18 Muaj	Organizatë (OSHC)	Komunitetet lokale
<i>Grante partneriteti</i>	10.000 - 40.000	5-15 Muaj	Organizata (OSHC) (+ Të paktën 3 partnerë)	Autoritetet Lokale / sektori privat / Institucionet Arsimore Lokale / Shoqatat e biznesit lokal / Shoqatat tregtare ose profesionale

a) Moduli: Grantet iniciative:

Këto grante konsistojnë në mbështetjen financiare të OSHC-ve në zbatimin e aktiviteteve specifike mjedisore në njësinë e tyre territoriale ku janë regjistruar apo kanë përqendruar aktivitetin gjatë vitit të fundit.

Në grantet e iniciativës kërkohen të mbështeten organizata të vogla të cilat kanë një vit eksperiencë në fushën e mjedisit dhe mund të ngrenë problematika mjedisore lokale. Këshillojmë që një organizatë medoemos të aplikojë për një tematikë e cila është në linjë fillimisht me eksperiencën e saj dhe më tutje me profilin e ekspertizës

Një organizatë mund të aplikojë vetëm një herë në këtë modul të granteve të iniciativës. Organizatat të cilat kanë aplikuar për grantet e iniciativës kanë mundësinë të përfshihen si organizata partnere vetëm në një aplikim tek grantet e partneritetit. Në të gjitha rastet, këshillojmë organizatat të shmangin mbivendoje të aktiviteteve dhe buxheteve në dy aplikime të ndryshme.

b) **Moduli: Grante Partneriteti:**

Këto grante janë për përfituesit e aktiviteteve që kërkojnë të bashkëpunojnë strategjikisht me njësitë e qeverisjes vendore, njësitë e dedikuara mjedisore dhe sektorin privat, institucionet arsimore në njësinë e tyre territoriale për një temë specifike mjedisore ku duhet të përfshihen të paktën **3 aktorë përveç liderit që me detyrim duhet të jetë OSHC Mjedisore :**

- (i) organizata udhëheqëse,
- (ii) organizata partnere lokale dhe,
- (iii) njësitë vendore, institucionet arsimore, akademi, komunitet, grupime kulturore, gjinore etj.

Çdo grant i partneritetit duhet të ketë vetëm një OSHC udhëheqëse, e cila do të jete edhe përgjegjëse për administrimin teknik dhe financiar të projektit dhe zhvillimin e aktiviteteve në rrjet. Organizata partnere duhet të ketë rol aktiv si në implementimin e aktiviteteve të projekti ashtu edhe në komponentin financiar por në asnjë rast duke marrë rolin e ndërmjetësit midis palëve.

Autoritetet lokale, sektori privat, institucionet arsimore lokale² dhe bizneset të cilat do të përfshihen në projekt duhet të jenë pjesë e partneritetit si partnerë pa buxhet. Këtu lejohen të buxhetohen vetëm shpenzime që lidhen me dieta apo kosto operative të angazhimit tematik të tyre.

Organizata udhëheqëse do të jetë përgjegjëse për raportimin financiar dhe narrativ kundrejt **Grantdhënësit**.

Kujdes!!! Një organizatë mund të aplikojë **vetëm një herë** si **Lider në modulin e partneritetit** dhe mund të jetë vetëm një herë partner në një aplikim tjetër ku nuk janë vetë lider dhe ndërhyrja nuk është në të njëjtin Qark apo Bashki.

KRITERET E THIRRJES

Kemi tri nivele të kriterëve të lejueshmërisë që lidhen me:

(1) Aktorët

Aplikanti kryesor duhet të përmbush kriteret e mëposhtme për të aplikuar:

1. Të jetë Organizatë joqeveritare (OJQ) ose jofitimprurëse (OJF) e regjistruar dhe me status aktiv referuar legjisllacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e Organizatave në Shqipëri.
2. Të jetë organizatë që ka në fokusin e vet mjedisin dhe mbrojtjen e promovimin e habitateve.
3. Të ketë minimalisht 1 vit eksperiencë nëse do të aplikojë tek grantet e iniciativës dhe minimalisht 3 vjet eksperiencë nëse do të aplikojë si lider tek grantet e partneritetit.
4. Të jetë nga rajoni, bashkitë, fshatrat së cilës i adreson zbatimin e projekt propozimit.
5. Të ketë një marrëveshje partneriteti (vetëm në rastin e aplikimeve për grante partneriteti) me partnerët e projektit;
6. Të mos ketë konflikt interesi me asnjë nga organizatat partnere të Green-AL si edhe mbivendoje të aktiviteteve me projekte që janë ende nën marrëdhënie kontraktuale. Nëse gjatë zbatimit të marrëveshjes lind ndonjë konflikt interesi, përfituesi duhet të njoftojë menjëherë organizatën Grant Dhënëse.

² Personat nga institucionet arsimore të përfshirë në projekt në kuadër të një kërkimi shkencor apo dicka të ngjashme mund të kostojnë vetëm dietat ditore apo kostot e udhëtimeve në rast se do të ketë

Aplikanti kryesor gjithashtu është përgjegjës:

- a. Të paraqesë aplikimin;
- b. Të nënshkruajë kontratën e grantit në rast të shpalljes fitues;
- c. Të jetë përgjegjësi i drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe menaxhimin e Projektit dhe jo të veprave si ndërmjetës;
- d. Të menaxhojë fondet e grantit dhe të bëjë të gjitha pagesat në përputhje me aktivitetet dhe kostot e parashikuara;
- e. Të konfirmojë lejueshmërinë e të gjitha kostove, përfshirë kosto si ato të faturuara nga partneri i projektit, nëse ka.

Partnerët në projekt:

1. Të jenë organizatë e formës së mëposhtme:
 - 1.1. Organizatë joqeveritare (OJQ) ose jofitimprurëse (OJF) siç janë organizatat për mbështetjen e biznesit, shoqatat e ndërmarrjeve vendore, agjencitë e zhvillimit, Bashkitë, Agjensi e zonave të mbrojtura, inspektorate, shoqatat e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), institucionet arsimore, trajnuese, kërkimore dhe zhvillimore (R&D), etj;
 - 1.2. Operatorë ekonomikë nga sektori privat dhe biznese vendore;
 - 1.3. Komuniteti vendor;
 - 1.4. Autoritet lokal (Bashki, Drejtori, Agjensi etj)
2. Të ushtrojnë veprimtari në zonën gjeografike ku do të zbatohet projekti;
3. Të kenë marrëveshje partneriteti me aplikantin kryesor.
4. Partnerët e tipit Organizata dhe Institucionet Akademike mund të përfshihen në zërat e buxhetit.
5. Bashkia, autoritetet lokale, bizneset mund të jenë vetëm partnerë pa buxhet të dedikuar dhe nuk ka të drejtë të jetë pjesë e më tepër se 1 partneriteti nën këtë titull.
6. Partnerët duhet të zbatojnë aktivitetet e parashikuara ku ata janë qartazi përgjegjës që në aplikim;
7. Të mos veprojnë si ndërmjetës;

(2) Projektet

Të dy modulet e nën-granteve si ai i *Iniciativës* edhe i *Partneritetit* synojnë të adresojnë tematika mjedisore të cilat janë të lidhura ngushtësisht me efektin që ato kanë mbi komunitetin.

Do të trajtohen me prioritet aplikime të cilat adresojnë gjetjet e pasqyruara në dokumentin e Vlerësimit të Nevojave "Needs Assessment Report" (prezantim i planifikuar të jepet gjatë sesioneve informuese) për secilin nga rajonet por në të njëjtën kohë nuk do të jetë penalizues fakti që një organizatë paraqitet me një aplikim i cili sjell risi apo është mëse aktual për komunitetin në fjalë dhe jo një përsëritje apo riciklim i projekteve të mëparshme.

Gjithashtu, Green-AL përgjatë planifikon të organizojë 2 sesione orientuese (kombinuar me procesin e inkubimit) për secilin rajon ku aplikantët e interesuar mund të diskutojnë dhe dakordësojnë tematikat e përzgjedhura për:



- Adresimin më të mirë të çështjen mjedisore nëpërmjet projektit Green-AL;
- Shmangien e mbivendosjes së tematikave të ngjashme për të njëjtin rajon;
- Përputhshmërinë e konceptit të tyre me objektivat e projektit, mënyrën e shkrimit të propozimit dhe menaxhimit e raportimit të saj

Me rëndësi: Përparësi do të marrin projektet që kanë nën-temat e mëposhtme sipas rajoneve:

Rajoni Qendror

- Ndërgjegjësim mjedisor
- Mbrojtje e ripërtëritje të burimeve natyrore
- Menaxhim të mbetjeve dhe Ndotje Urbane
- Ndryshime klimatike
- Mobilitet dhe Ekonomi Qarkulluese

Rajoni Veri-Lindor

- Mbrojtje të burimeve ujore
- Ndërgjegjësim mjedisor
- Menaxhim të mbetjeve
- Mbrojtje e ripërtëritje të burimeve natyrore
- Ndotje urbane

Rajoni Veri-Perëndimor

- Menaxhim të mbetjeve
- Ndotje të ujërave
- Mbrojtje e ripërtëritje të burimeve natyrore
- Ndotje Urbane
- Ndërgjegjësim Mjedisor

Rajoni Jugor/COSV

- Mbrojtje e ripërtëritje të burimeve natyrore
- Ndërgjegjësim mjedisor
- Mbrojtje të burimeve ujore dhe bregdetare
- Menaxhim të mbetjeve
- Ndotje Urbane

Kriteret shtesë që përbëjnë vlerë të shtuar përfshijnë: organizata që bëjnë monitorime specifike të çështjeve mjedisore, trajtojnë dhe promovojnë çështjet gjinore, të drejtat e njeriut dhe të pakicave, bashkëpunime me akademinë të cilat ndikojnë në nxitjen e kërkimit shkencor në fushat mjedisore, investime të vogla apo pilotime të cilat zgjidhin çështje me rëndësi të veçantë për publikun e komunitetin, etj.

Konsiderata në nivel social: Duke qenë se çështjet mjedisore kanë një dimension social, të tilla si: reformat aktuale lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në BE, niveli i ulët i bashkëveprimit ndërmjet OSHC-ve për të promovuar mbrojtjen e mjedisit në një njësi të caktuar territoriale përtej jetëgjatësisë së një projekti, etj. Sugjerojmë që aplikantët të përfshijnë në propozimin e tyre procese të përpunimit grafik të informacioneve që derivojnë nga vendime autoritetesh, iniciativa, ndërhyrjeve apo raporteve “teorike” dhe “teknike” në një informacion që mund të kuptohet lehtësisht nga qytetarët dhe komunitetet në përgjithësi, nëpërmjet info-grafikëve, lajmeve në media, vizitave në terren, etj.

Konsiderata në nivel mjedisor: Çdo aplikim duhet të shmang përdorimin e plastikës një-përdorimësh në çdo aktivitet apo produkt të saj, në rast të kundërt kostot nuk do të mbulohen nga autoriteti grantdhënës. Të gjithë produktet, investimet apo printimet nga ky projekt duhet të jenë miqësore me mjedisin ose materiale të ripërdorura, të ricikluara.

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Mbështetur nga Qeveria e Suedisë



Konsiderata në nivel akademik dhe institucional: Sidomos për grantet e partneritetit, efektet e ndërhyrjes që propozohen duhet të jenë pozitive dhe prekshme. Duke qenë se do të lejohen investime në masën 25% të buxhetit total, ndërhyrjet konkrete (që nga parandalimi dhe mbrojtja e mjedisit, ekspeditat kërkimore, monitorimi mjedisit dhe deri në ndërhyrje të drejtpërdrejta) duhet të adresojnë gjithnjë një nevojë apo të mire publike. Sikurse mund të jete edhe mbështetja në përmbushjen e një detyrimi ligjor të lidhur me mjedisin nga ana e institucioneve lokale.

(3) Kostot

Vetëm "kostot e pranueshme" mund të merren parasysh për një grant. Kategoritë e kostove të konsideruara si të pranueshme dhe jo të pranueshme paraqiten si më poshtë. Vini re, se kostot e pranueshme duhet të bazohen në kosto reale bazuar në dokumentet mbështetëse.

Rekomandimet për dhënien e një granti gjithmonë i nënshtrohen kushtit që procesi i kontrollit para nënshkrimit të kontratës të mos nxjerrë në pah probleme që kërkojnë ndryshime në buxhet (*për shembull gabime aritmetike, pasaktësi ose kosto joreale dhe kosto të tjera të papranueshme*).

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit mund të bëjë modifikime ose ulje në shumën e grantit të kërkuar, në rast se vërehen gabime ose pasaktësi të tilla. Shuma e grantit, si rezultat i këtyre korrigjimeve, nuk mund të rritet, për këtë arsye është në interesin e aplikuesit të sigurojë një buxhet realist dhe me kosto efektive.

Kosto të pranueshme

Kostot e pranueshme janë ato kosto që:

- janë zhvilluar gjatë zbatimit të aktiviteteve siç specifikohet në kontratë. Kjo do të thotë që kostot kanë të bëjnë me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit;
- pasqyrohen në buxhetin e përgjithshëm të aktivitetit (*në formatin e aneksuar të buxhetit*);
- janë të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve;
- mund të gjurmohen dhe verifikohen në origjinë, veçanërisht të regjistruara në regjistrat kontabël të Përfituesit të Grantit dhe të përcaktuara në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë;
- janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm tatar;
- respektojnë rregullat e kombësisë dhe origjinës.
- Për çdo blerje në vlerë mbi 2500 Euro, organizata zbatuese e grantit duhet të aplikoj proces të hapur tenderimi ku të paktën të sigurohen 3 oferta, të cilat bazohen mbi çmime referencë të tregut.

Janë të pranueshme kostot e mëposhtme nga Përfituesi i Grantit:

- kostot e stafit të caktuar në projekt-propozim, që korrespondon me pagat aktuale bruto duke përfshirë tarifën e sigurimeve shoqërore dhe kostot e tjera të lidhura me shpërblimin;
- shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt, me kusht që të jenë kosto reale të konfirmuara nga dokumente mbështetëse;
- kostot e blerjeve për pajisje (*të reja ose të përdorura*) dhe shërbime të posaçme për qëllimet e projektit.

E rëndësishme: Vini re se taksat, përfshirë TVSH-në do të aprovohen si kosto të pranueshme vetëm kur të plotësohen kushtet e mëposhtme (*dhe të konfirmuara nga dokumentet mbështetëse*):

- Taksat e vlerës së shtuar nuk janë të rimbursueshme në asnjë mënyrë;



- Sipas praktikës, ato do të përballohen nga përfituesi; dhe
- Ato pasqyrohen qartë në projekt propozim.

Kostot e mëposhtme nuk do të konsiderohen të pranueshme:

- borxhe dhe tarifat e shërbimit të borxhit (*interesat*);
- dispozita për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- kosto të deklaruara nga Përfituesi dhe të financuara nga donatorë ose nga veprime të tjera të financuara nga Sida;
- humbjet e këmbimit valutor;
- kredi për palët e treta;
- kostot e pagave të personelit të administratës shtetërore, publike

VIZIBILITETI

Mbështesim aplikantët lider tek grantet e partneritetit që në propozimet e tyre të krijojnë hapësirën e nevojshme për përfshirjen e një personi të dedikuar që do të merret me komunikimin e propozimit tuaj. Kësisoj, theksojmë se komponenti i komunikimit në tërësi është i rëndësishëm për qasjen që Green-AL ka ndaj propozimeve.

Organizatat fituese, do të jenë pjesë e një trajnimit të dedikuar mbi zbatimin e Strategjisë së Komunikimit dhe Rregullat e Brandim-it që Green-AL ka zhvilluar së brendshmi.

E rëndësishme: Varësisht dhe në përputhje me zbatimin e politikave për parandalimin dhe/ose zbutjen e përhapjes së COVID-19, në çdo rast, aktivitetet e propozuara do duhet të marrin në konsideratë kufizimet e mundshme dhe të propozojnë mënyra alternative të lejuara për të siguruar vazhdimësinë dhe zbatimin me efikasitet të plotë të aktiviteteve të parashikuara.

VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Një bord i dedikuar do të ngrihet posaçërisht me vendim të brendshëm nga Co-PLAN, anëtarët e të cilit do të mandatohen për të siguruar vlerësim objektiv, teknik dhe strategjik ndaj projekt – propozimeve.

Vlerësimi është planifikuar të kalojë në 3 faza të brendshme nga autoriteti kontraktor:

i. Kontrolli Administrativ dhe Vlerësimi Paraprak

I cili konsiston në:

- Hapjen e aplikimit
- Regjistrimin e detajuar të materialeve pjesë e aplikimit
- Vlerësimin e vlefshmërisë së tyre
- Vlerësimi paraprak nga menaxheri projektit

Përgjatë vlerësimit paraprak, më specifikisht do të kontrollohen:

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Mbështetur nga Qeveria e Suedisë



Kriteret Administrative	Po	Jo	Komente
1. Propozimi është dorëzuar brenda afatit dhe rregullave.			
2. Aplikimi ka respektuar formatin e kërkuar.			
3. Propozimi është në gjuhën shqipe dhe shoqërohet nga një përmbledhje në gjuhën angleze.			
Dokumentet Mbështetës	Po	Jo	Komente
Aplikuesi - person juridik (OSHC/OJF) - Vendimi i regjistrimit në gjykatë (kopje); - Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje); - Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (kopje); - Profili Organizativ ku evidentohet qartë përvoja e punës në fushën mjedisit			
Buxheti, kohëzgjatja dhe nr. i aplikimeve			
Buxheti total i projektit është brenda limiteve të kërkuara			
Kohëzgjatja e projektit është nga 5 deri në 18 muaj (varësisht lotit dhe përcaktimeve);			
Aplikuesi ka paraqitur vetëm një aplikim (ose si Aplikues, ose si Bashkë-Aplikues).			

Procesi vlerësues i granteve do të procedojë me aplikantët të cilët kanë kaluar fazën e kontrollit të parë.

ii. Vlerësimi Cilësor/Përmbajtjesor i Aplikimit të Plotë

Cilësia e aplikimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit të plotë që janë në tabelën më poshtë me reference seksionet e formatit të aplikimit:

Relevanca	Rezultati maksimal (pik)
1. Kapaciteti operacional / teknik	Referenca me Propozimin Kap. 8 dhe 4.C
A ka aplikanti ekspertizë të mjaftueshme teknike (veçanërisht njohuri për çështjet që do të adresohen në lidhje me mjedisin)	5 (pike)
A ka aplikanti kapacitet të mjaftueshëm menaxhues (përfshirë stafin, pajisjet dhe aftësinë për të trajtuar buxhetin për aktivitetet e parashikuara)?	5 (pike)
2. Rëndësia e veprimit	Referenca: Kap. 4.a, b dhe 4.1,4.2, 4.3

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Mbështetur nga Qeveria e Suedisë



Sa i rëndësishëm është propozimi për adresimin apo zgjidhjen e problematikës mejdore në rajonin përkatës?	10 (pike)
Sa qartë janë përcaktuar dhe zgjedhur strategjikisht ata që janë përfshirë (<i>përfshirë përfundimtarë, grupet e synuara, si do të afrohen dhe përfshihen aktorët</i>)?	5 (pike)
A janë përcaktuar qartë nevojat e tyre dhe a i adreson propozimi në mënyrë të përshtatshme?	5
3. Projektimi i veprimit	Referenca: Kap 4.3, 4.4, 4.5
Sa koherent është modeli i përgjithshëm i veprimit? Në veçanti, a pasqyron ajo analizën e problemeve, të marrë parasysh faktorët e jashtëm dhe palët e interesuara përkatëse?	10 (pike)
A është veprimi i realizueshëm dhe i qëndrueshëm në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritura?	10 (pike)
4. Efektiviteti dhe realizueshmëria e propozimit	Referenca: Kap. 4.d dhe 5, 7
Inovacioni/risia që sjell modeli i propozuar. ?	10 (pike)
A është i qartë dhe i realizueshëm plani i veprimit dhe a janë paraqitur indikatorët mbi të cilët do vlerësohet përmbushja e objektivit të propozimit?	10 (pike)
5. Buxheti dhe efektiviteti i koston	Referenca: Kap. 5, 6
A janë aktivitetet e pasqyruara në mënyrë të përshtatshme në buxhet?	10 (pike)
A është racional raporti midis kostove dhe rezultateve të pritura? <i>*Investimet e parashikuara do të jenë subjekt vlerësimi të detajuar dhe miratimi vetëm nga ana e Co-Plan.</i>	10 (pike)
6. Qëndrueshmëria e partneritetit	Referenca: Kap. 4.6, 4.5, 4.2
A ka të ngjarë që projekti i propozuar të ketë një ndikim të prekshëm në grupet e synuara?	5 (pike)
A ka të ngjarë që projekti i propozuar të ketë efekt pozitiv dhe replikues të vetvetes? (<i>Përfshirë hapësirën për replikim dhe zgjerim të rezultatit të veprimit dhe shpërndarje e informacion</i>)	5 (pike)
PIKËT TOTALE MAKSIMALE	100 (pike)

Njoftimi për rezultatet dhe mundësia për ankimim

Aplikantët do të njoftohen me shkrim për vendimin e bordit vlerësues në lidhje me aplikimin e dorëzuar. Kjo letër do të dërgohet fillimisht e skanuar me e-mail.

Një aplikant që beson se është vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit mund të bëjë ankimim brenda 10 (dhjetë) ditëve (*ditë pune*) nga dita që ka marrë njoftim për refuzim. Gjithashtu ai është i detyruar të tërheq dokumentin origjinal të vlerësimit të tij brenda kësaj periudhe.

Ankesat do të shqyrtohet dhe përgjigja do të kthehet brenda 5 ditëve (*ditë pune*) që nga paraqitja me shkrim e ankimit.



Kontraktimi: Përpara nënshkrimit të kontratës, Co-PLAN (si përgjegjës për zbatimin e skemës së granteve) rezervon të drejtën për të negociuar me aplikuesin në mënyrë që të sigurojë efikasitetin maksimal për shpenzimet e parashikuara në kuadër të këtij projekti.

iii. Procedura e përzgjedhjes

Vetëm aplikimet me rezultat **të paktën 70 pikë** do të konsiderohen të suksesshme dhe do të konsiderohen për fazën përfundimtare të përzgjedhjes së aplikimit fitues. Renditja e projekteve të klasifikuara si fitues kombinuar me shpërndarjen e barabartë gjeografike të buxhetit të thirrjes do të përcaktojnë në fund edhe fituesit final.

Autoriteti Kontraktues në fazën e parë do të zgjedhë propozimet më të mira për financim.

Sidoqoftë, për të siguruar mbulim të një fushë të gjerë temash, Autoriteti Kontraktues mund të refuzojë një propozim nëse ka propozime të tjera që mbulojnë të njëjtën tematikë të cilët kanë marrë një vlerësim më të mirë. Në mënyrë të ngjashme.

Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues

Aplikanti do të informohet përmes postës elektronike për vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e tyre dhe, nëse refuzohet, arsyet e vendimit negativ do të paraqiten në përputhje me rrethanat.

Pas vendimit për dhënien e një nën-granti, Përfituesit do t'i ofrohet një marrëveshje.

Kontratat, raportimet dhe pagesat përfundimtare

Pagesa do të planifikohet në 4 faza kryesore:

- Përfituesit do të marrin paradhënie, 40% të shumës totale të grantit pas nënshkrimit të kontratës;
- Pagesa e ndërmjetme prej 40% pas dorëzimit të raportit të parë të ndërmjetëm narrativ dhe financiar (deri në fund të muajit të 9-të nga nënshkrimi i kontratës);
- Pagesa përfundimtare (10%) do të transferohet pas miratimit të përditësimeve të raportit përfundimtar narrativ dhe financiar.

KALENDAR INDIKATIV I PROCESIT		
	Data	Ora
Shpallja publike e Thirrjes për Projekt - Propozime	14/07/2021	16:00
Afati i fundit kohor për t'i drejtuar pyetje sqaruese Autoritetit Kontraktues	20/08/2021	16:00
Data e fundit në të cilën publikohen sqarimet nga Autoriteti Kontraktues	30/08/2021	16:00
Afati i fundit kohor për dërgimin e Aplikimeve	15/09/2021	16:00
Informimi i aplikantëve mbi vlerësimin e aplikimit të plotë	05/10/2021	16:00
Afati i fundit në dispozicion për ankimim	15/10/2021	16:00
Njoftimi për akordimin e granteve (pas kontrollit të pranueshmërisë)	28/10/2021	16:00
	30/10/2021	

E rëndësishme:

Parandalimi dhe eliminimi i çdo ndërhyrjeje arbitrare dhe/apo favorizuese është prioritet për Co-PLAN dhe partnerët. Procesi do të jetë transparent dhe informacioni në të gjithë hapat e tij do të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i shoqëruar nga sesione orientuese, ofruar nga partnerët Green-AL.

Partnerët zbatues të projektit Green-AL



Mbështetur nga Qeveria e Suedisë

